

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Kryeministria
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva / Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Projektligji nuk është i lidhur me publikime apo strategji.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	21/10/2022
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	09/11/2022
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 24/10/2022
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2022 – KM – Nr. 2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Vangelt Duni vangelt.duni@kryeministria.al , 0695601625
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i> Zbatimi i ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 112/2013) ka sjellë shumë problematika në praktikë dhe zbatimin e gabuar të ligjit, për arsyet vijuese: ❖ Nuk ka përcaktuar në mënyrë të qartë subjektet të cilëve u jepen titujt; ❖ Konfondon ato që tradicionalisht kategorizohen si dekorata – urdhra dhe medalje, me titujt e nderit. Pra, për shkak të këtij konfuzioni dhe kategorizimi të ligjit aktual, është krijuar një tablo e pasaktë dhe e tejzgjeruar e titujve kombëtarë të nderit. ❖ Nuk parashikon raste kur u hiqet titulli i nderit subjekteve; ❖ Nuk parashikohet e drejta të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar dhe dhënë tituj sipas përcaktimit të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 113, të Kushtetutës; ❖ Duke qenë se të drejtën e dhënies së titujve të nderit e kanë vetëm një numër i kufizuar institucionesh, nuk është dhënë mundësia që edhe qytetarët të propozojnë dhënien e titullit të nderit ose titullit vendor të nderit për persona për të cilën vlerësojnë se duhen nderuar.	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)</i>	

Historik

Objektivi kryesor i përgjithshëm i këtij projektligji është rikonceptimi dhe riorganizimi i sistemit të titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë, qoftë të atyre që jepen nga kryetari i shtetit, qoftë të titujve vendorë që jepen nga organet e vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet këtij projektligji, synohet krijimi i një praktike të konsoliduar dhe unifikuar në drejtim të procedurave që ndiqen për dhënien e titujve. Më specifikisht, qëllimet janë si vijon:

- ❖ Ndarja dhe dallimi i “titujve të nderit” nga “dekoratat”, të cilat janë propozuar të rregullohen nëpërmjet një projektligji tjetër;
- ❖ Vendosja e një sistemi titujsh bashkëkohor dhe jetëgjatë;
- ❖ Ndarja dhe diferencimin i secilit prej titujve të nderit, sipas specifikave përkatëse, duke përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet për përfitimin e tyre;
- ❖ Përcaktimi në mënyrë të qartë të subjekteve të cilëve u jepen tituj;
- ❖ Garantimi i së drejtës së njësive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar tituj vendorë;
- ❖ Riorganizimi i procedurës së shqyrtimit të nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve nga autoritetet përgjegjëse.
- ❖ Garantimi i mundësisë për të dhënë tituj bazuar edhe në propozimet që vijnë nga qytetarët.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 1 - Mosndryshimi i ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Opsioni 2 - Kryerja e ndryshimeve në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Qeveria Shqiptare ka vlerësuar opsionet e mundshme për adresimin dhe trajtimin e problematikave të mësipërme që kanë ardhur nga keqzbatimi dhe abuzimi me kompetencat dhe funksionet ligjore në dhënien e titujve, duke shqyrtuar mundësinë e bërjes së disa ndryshimeve në ligjin nr. 112/2013 të sipërcituar. *Prima facie* rezulton si një opsion që mund të aplikohet me më pak kosto kohore dhe organizative është ndryshimi i ligjit, duke kryer ndërhyrje vetëm në problematikat kryesore që janë evidentuar gjatë zbatimit në praktikë të ligjit. Mirëpo, adresimi vetëm i disa prej problematikave nuk i shërben përmbushjes së qëllimit të ligjbërësit, si dhe mund të krijojë dyshime mbi stabilitetin e ligjit dhe të lëkundë besimin në të.

Për të arritur objektivat nevojiten të kryhen ndryshime tërësore që nga parimet kryesore të ligjit ekzistues dhe në tërësi e gjithë struktura e tij, ndryshime të cilat tejkalojnë masën 70 përqind. Këto ndryshime prekin thelbin e ligjit nr. 112/2013 dhe nuk rregullojnë vetëm disa aspekte të tij, ndaj u vlerësua si opsion i përshtatshëm mundësia e miratimit të një ligji të ri.

Në rast se do të vijohej me ndryshime në ligjin ekzistues, vlerësohet se nuk do të arrihej objektivi kryesor për rikonceptimin dhe riorganizimin e sistemit të titujve dhe titujve vendorë në Republikën e Shqipërisë.

Opsioni 3 - Hartimi i një ligji të ri për dekoratat në Republikën e Shqipërisë.

Në raport me dy opsionet e tjera, opsioni 3 është vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm referuar objektivave që synohen të arrihen në këtë rast që konsistojnë në përmirësimin e organizimit të sistemit të titujve dhe titujve vendorë të Republikën e Shqipërisë, si dhe në unifikimin e procedurave që ndiqen për dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Këto objektiva të parashtruara në nivel makro nuk mund të arrihen nëpërmjet ruajtjes së *status quo*-së, pasi është e nevojshme ndërhyrja

ligjore dhe as nëpërmjet opsionit 2, për shkak të ndryshimeve dhe risive që parashikon projektligji në raport me ligjin nr. 112/2013 që është në fuqi aktualisht.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Avantazhet dhe disavantazhet, direkte apo indirekte, të opsionit të tretë, pra hartimi i një ligji të ri janë:

Avantazhet direkte janë:

1. Ekonomike

Për subjektet që do t'i jepen tituj nderi dhe tituj vendorë nderi, dhënia e këtyre të fundit nuk do të shoqërohet me një shpërblim financiar në dallim nga legjislacioni aktual në fuqi, duke mos rënduar buxhetin e shtetit në këtë drejtim. Projektligji nuk parashikohet të sjellë rritje të shpenzimeve buxhetore pasi nuk përcakton detyra të reja të institucioneve zbatuese (dhënia e titujve të nderit është veprimtari ekzistuese) dhe as nuk sjell krijimin e institucionave, organeve, apo strukturave të reja.

2. Sociale

Ndër ndikimet sociale direkte mund të përmendim shtimin e motivimit dhe frymëzimit për kryerjen e veprimeve me vlerë e meritë për përparimin e shoqërisë dhe kombit, shtimin e ndjenjës së përkatësisë dhe pjesëmarrjes në një proces të rëndësishëm për njohjen e kontributeve të dhëna për komunitetin dhe Kombin shqiptar (procedura e iniciativës qytetare), lartësimin e vlerës së titujve të shpërndara, si dhe ruajtjen e imazhit të vendit nga zhvlerësimi i mëtejshëm për shkak të abuzimit me dhënien e titujve, që nënkupton një avantazh të madh social, ekonomik (indirekt), duke justifikuar plotësisht ndërmarrjen e kësaj nisme.

Avantazhet indirekte janë me karakter social dhe lidhen me forcimin e unitetit shoqëror dhe respektit për kontribuesit në përparimin e shoqërisë dhe kombit mund të evidentohet si një ndikim social indirekt i kësaj politike.

2.Disavantazhet, direkte ekonomike lidhen me subjektet që do t'i jepen tituj nderi dhe tituj vendorë nderi, pasi dhënia e këtyre të fundit nuk do të shoqërohet me një shpërblim financiar në dallim nga legjislacioni aktual në fuqi, ndërsa ato indirekte janë me karakter sociale që lidhen me subjektet të cilëve më parë i janë dhënë tituj nderi ose tituj vendorë nderi dhe të cilët për shkak të kryerjes së veprave penale do t'i hiqet titulli.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 3 është vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm referuar objektivit për rikonceptimin dhe riorganizimin e sistemit të titujve të nderit dhe titujve vendorë të nderit, si dhe në unifikimin e procedurave që ndiqen për dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Këto objektiva të parashtruara në nivel makro nuk mund të arrihen nëpërmjet ruajtjes së *status quo*-së, pasi është e nevojshme ndërhyrja ligjore dhe as nëpërmjet opsionit 2, për shkak të ndryshimeve dhe risive që synohen të kryhen dhe realizohen në kuadër të përmbushjes së politikës për përmirësimin e sistemit të titujve të Republikën e Shqipërisë.

Pas vlerësimit në tërësi dhe me kujdes të këtyre opsioneve, rezulton se opsioni 3, pra hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,

krijon mundësitë optimale për implementimin e plotë të politikës dhe arritjen efektive të objektivave të vendosura. Edhe sipas analizës me shumë kritere, ky opsion merr më shumë pikë.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Për sa i përket konsultimit publik, sipas ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, sqarojmë se projektligji aktualisht është në procedurë konsultimi e sipër. Ai është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike në datën 21.09.2022 dhe procedura e konsultimit, gjatë së cilës palët e interesuara kanë patur mundësinë të paraqesin komentet e tyre, ka vijuar deri në datën 21.10.2022 (data e mbylljes së konsultimit). Në përfundim ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe nuk janë paraqitur vërejtje, sugjerime, apo komente për projektligjin.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë:

1. Presidenti i Republikës dhe Këshillat bashkiake, në cilësinë e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.
2. Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetarët e bashkive dhe cdo anëtar i këshillave bashkiake, në cilësinë e autoriteteve që kanë të drejtën e propozimit për nderim;
3. Këshilli i Ministrave i cili ngarkohet për nxjerrjen e akteve nëligjore.

Para se të ndalemi në kontekstin e politikës vendase për sistemin e titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë, sqarojmë se sistemet e dekorimeve në botë janë të ndryshme, duke nisur nga sistemi anglosakson, i përqendruar kryesisht tek Britania e Madhe, Amerika dhe ish kolonitë e tyre, më pas sistemi kontinental evropian, me bazë sistemin francez dhe ish kolonitë e tyre, sistem i ndjekur nga shteti shqiptar deri më 1944-ën, si dhe sistemi sovjetik, të cilin e kanë pasur ish-vendet e bllokut lindor, midis të cilëve edhe Shqipëria deri në vitin 1990-të.

Sistemi i titujve në Republikën e Shqipërisë deri më sot është paraqitur si një sistem i veçantë, i dallueshëm nga sistemet e mësipërme për shkak të veçorive që karakterizojnë këtë sistem. Dhënia e titujve sipas ligjit parashikohet si një kompetencë kushtetuese për Presidentin e Republikës, referuar nenit 92, shkronja “ç” të Kushtetutës, si dhe organeve të qeverisjes vendore sipas nenit 113, pika 1, shkronja “dh”. Aktualisht, sistemi i titujve është i parashikuar në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Referuar situatës së deritanishme, titujt dhe titujt vendorë në Shqipëri janë dhënë në kushtet e mungesës së transparencës sa i takon procedurës së verifikimit dhe shqyrtimit të kushteve ligjore, si dhe meritës apo kontributit të shquar të personave në favor të të cilit është dhënë titulli përkatës. Shpeshherë ky proces është shoqëruar apo ndikuar nga interesa të caktuara politike. Kjo ka sjellë që në shumicën e rasteve të vihet në diskutim dhënia e tyre për persona të ndryshëm. Kjo situatë ka ndikuar në krijimin e një mosbesimi në drejtim të meritokracisë duke qenë se titujt herë i janë dhënë personave që vërtetë kanë kryer veprimtari të shquara dhe herë personave të tjerë në bazë të interesit të momentit.

Gjithashtu, ka ende rastet kur personat që nuk jetojnë më, vijojnë të marrin tituj pas vdekjes. Kjo ka sens kur nderimi i tyre është mohuar në një regjim tjetër, pra si proces rehabilitimi, por jo brenda të njëjtit regjim, pasi personat që nuk jetojnë nuk mund të shfaqin merita të reja për të cilat të rivlerësohen më shumë.

Problemi në shqyrtim

- ❖ *Përshkruani natyrën e problemit.*
- ❖ *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- ❖ *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- ❖ *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- ❖ *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Sikurse është parashtruar edhe më sipër, zbatimi i ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 112/2013) ka sjellë shumë problematika në praktikë dhe zbatimin e gabuar të ligjit, për arsye vijuese:

- ❖ Ligji nr. 112/2013 nuk ka pasur të përcaktuar në mënyrë të qartë subjektet të cilëve u jepen titujt sipas kushteve dhe kriterëve ligjore, duke përmendur vetëm termat “personalitete shqiptare” apo personalitete të huaja”;
- ❖ Sa i takon llojeve të titujve, në ligj nuk i është kushtuar rëndësi e veçantë ndarjes dhe zbërthimit specifik të secilit prej tyre duke përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet për përfitimin e tyre, si dhe rregullat për dhënien e tyre; ky ligj ndalet vetëm në përkufizimin e tyre, pa u ndalur në përcaktimin e rregullave materiale në lidhje me dhënien e tyre;
- ❖ Ligji aktual ngatërron ato që tradicionalisht kategorizohen si dekorata – urdhra dhe medalje, me titujt e nderit. Pra, për shkak të këtij konfuzioni dhe kategorizimi të ligjit aktual, është krijuar një tablo e pasaktë dhe e tejzgjeruar e titujve kombëtarë të nderit.
- ❖ Ligji nr. 112/2013, nuk parashikon raste kur u hiqet titulli i nderit subjekteve;
- ❖ Problematikë tjetër e evidentuar është edhe fakti që në legjislacionin aktual nuk parashikohet e drejta të njësive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar dhe dhënë tituj sipas përcaktimit të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 113, të Kushtetutës. Sipas ligjit 112/2013, të ndryshuar, njësitë e qeverisjes vendore mund të japin titullin “Qytetar nderi” ose titullin “Nderi i qarkut”, duke përcaktuar kështu shprehimisht llojet e titujve që ato mund të japin, duke i kufizuar të drejtën për të krijuar vetë tituj vendorë.
- ❖ Ligji në fuqi parashikon krijimin e komisioneve këshillimore pranë çdo autoriteti për dhënien e dekoratave, i cili jep mendimin e tij për dhënien e titullit, por procedura e veprimit dhe funksionimit të këtyre komisioneve këshillimore nuk është e uniformizuar duke krijuar praktikë dhe standarde të shumëfishta në shqyrtimin e propozimeve për dhënien e titujve.
- ❖ Nga ana tjetër, duke qenë se të drejtën e dhënies së titujve të nderit e kanë vetëm një numër i kufizuar institucionesh, nuk është dhënë mundësia që edhe qytetarët të propozojnë dhënien e titullit të nderit ose titullit vendor të nderit për persona për të cilën vlerësojnë se duhen nderuar.

Arsyeja e ndërhyrjes

- ❖ *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- ❖ *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- ❖ *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- ❖ *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Për zgjidhjen efektive dhe adresimin e problematikave të evidentuar në seksionet e mësipërme, është menduar ndjekja e një qasjeje të re dhe implementimi i një politike të ndryshme nga ajo e ndjekur gjatë 3 dekadave të fundit. Një politikë e cila do të mund të garantojë vendosjen e një sistemi bashkëkohor dhe jetëgjatë, me rregulla të qarta, procedura rigorozë dhe efikase duke shmangur abuzimet dhe zhvlerësimin e imazhit të nderimeve.

Në këtë kontekst, ndërhyrja ligjore është e nevojshme për adresimin e çështjeve kryesore vijuese:

- ❖ rregullimin e sistemit të titujve, ndryshe nga ai aktual i cili konfondon ato që tradicionalisht kategorizohen si dekorata – urdhra dhe medalje, me titujt e nderit.
- ❖ për të përcaktuar rregulla të qarta lidhur me institucionet që kanë të drejtën e nismës dhe propozimit për të dhënë tituj nderi dhe tituj vendorë nderi;
- ❖ për të përcaktuar rregullave të qarta nëse dhënia e titullit ka apo jo efekte financiare, pra nëse dhënia e tij shoqërohet me shpërblim financiar;
- ❖ për të përcaktuar rregulla të qarta sa i takon procesit të shqyrtimit të propozimeve për dhënien e titujve, me qëllim zbatimin drejtë dhe efektiv të ligjit;
- ❖ për të përcaktuar rregulla të qarta për një sistem më të drejtë të meritës, larg preferencave klienteliste, për ta përdorur dhënien e titujve për vlera dhe jo për konsum pushteti, mirënjohje personale apo për shkak të presionit nga miqtë apo partitë politike.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi kryesor i përgjithshëm i këtij projektligji është rikonceptimi dhe riorganizimi i sistemit të titujve të nderit në Republikën e Shqipërisë, qoftë të atyre që jepen nga kryetari i shtetit, qoftë të titujve vendorë që jepen nga organet e vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet këtij projektligji, synohet krijimi i një praktike të konsoliduar në drejtim të procedurave që ndiqen për dhënien e titujve, për shqyrtimin e të gjitha nismave për nderim, të bëra kryesisht ose nga institucionet që kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e propozimit.

Më specifikisht, qëllimet që synon të përmbushë ky projektligj përmes parashikimeve të sanksionuara në të, paraqiten si vijon:

- ❖ Ndarja dhe dallimi i “titujve të nderit” nga “dekoratat”, të cilat janë propozuar të rregullohen nëpërmjet një projektligji tjetër;
- ❖ Vendosja e një sistemi titujsh bashkëkohor dhe jetëgjatë;
- ❖ Ndarja dhe diferencimin i secilit prej titujve të nderit, sipas specifikave përkatëse, duke përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet për përfitimin e tyre;
- ❖ Përcaktimi në mënyrë të qartë të subjekteve të cilëve u jepen tituj;
- ❖ Garantimi i së drejtës së njësive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar tituj vendorë;
- ❖ Riorganizimi i procedurës së shqyrtimit të nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve nga autoritetet përgjegjëse.

- ❖ Garantimi i mundësisë për të dhënë tituj bazuar edhe në propozimet që vijnë nga qytetarët.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. Përshkruani opsionin e status quo-së.
2. Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
3. Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.

Opsioni 0 (status quo) – Mosndryshimi i ligjit nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

❖ Avantazhet:

- Ekonomia administrative. Mosshpenzimi i kohës dhe burimeve të kufizuara të administratës për hartimin e ndryshimeve në legjislacionin ekzistues apo për hartimin e një ligji të ri.

❖ Disavantazhet:

- Vazhdimi i zbatimit të një sistemi jo të përshtatshëm për dhënien e titujve dhe titujve vendorë të nderit dhe që nuk mundëson arritjen e objektivave të vendosura të politikës. Problematikat mbeten të paadresuara.

Opsioni 1 (rregullator) – Kryerja e ndryshimeve në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

❖ Avantazhet:

- Njësoj si opsioni 0, edhe opsioni 1 mund të nënkuptojë shpenzime administrative dhe burime njerëzore më të pakta në raport me përzgjedhjen e opsionit të tretë.
- Opsioni për të kryer ndryshime në ligjin në fuqi mund të lejojë në evidentimin e dispozitave kryesore që kanë nevojë për ndryshim, shtimin e dispozitave të tjera që hartuesit e ligjit në fuqi nuk kanë përfshirë në të, si dhe arritjen e disa prej objektivave të vendosura.
- Njëkohësisht ky opsion mundëson dhe ndërhyrjen në aktet nënligjore në zbatim të ligjit, një ndërhyrje e cila nuk do të ishte e mundur pa kryerjen, më parë, të ndryshimeve në këtë ligj.

❖ Disavantazhet:

- Ndërmarrja e këtij opsioni nuk krijon stabilitet dhe qëndrueshmëri në zbatimin e ligjit. Ky opsion, nuk mundëson ndreqjen e plotë të problemeve të konstatuara, riorganizimin e sistemit të titujve dhe arritjen e objektivave të vendosura.
- Kërkohet ndërhyrja me ndryshimin e më shumë se 50% të dispozitave të ligjit ekzistues.
- Njëkohësisht, për të implementuar plotësisht politikën dhe për të arritur objektivat, sistemi aktual do duhet të ndryshohet plotësisht dhe kryerja e amendimeve në legjislacionin aktual nuk e mundëson arritjen e këtij qëllimi.

Opsioni 3 (rregullator) – hartimi i një ligji të ri për sistemin shqiptar të dekoratave.

❖ Avantazhet:

- Duke hartuar një ligj të ri mundësohet vendosja e një sistemi të ri, bashkëkohor dhe në linjë me modelet perëndimore në lidhje me sistemin e titujve dhe titujve vendor të nderit.

- Nëpërmjet këtij optionsi mund të ndreqen problemet e konstatuara si dhe të arrihen objektivat e vendosura.
- Garantimi i mundësisë për të dhënë tituj bazuar edhe në propozimet që vijnë nga qytetarët.
- Garantimi i së drejtës së njësive të vetëqeverisjes vendore për të krijuar tituj vendorë;
- Mundësohet ndërmarrja e masave si më poshtë vijon:
 - përcaktimi i rregullave dhe procedurave të qarta dhe rigorozë për vlerësimin e propozimeve të dhënies titujve të nderit dhe titujve vendor të nderit;
 - përcaktimi i rregullave për rastet e heqjes së titujve;
 - Ndarja dhe dallimi i “titujve të nderit” nga “dekoratat”;
 - Ndarja dhe diferencimin i secilit prej titujve të nderit, sipas specifikave përkatëse, duke përcaktuar qartësisht kriteret që duhet të përmbushen nga subjektet për përfitimin e tyre;
 - Përcaktimi në mënyrë të qartë të subjekteve të cilëve u jepen tituj;
 - Riorganizimi i procedurës së shqyrtimit të nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve nga autoritetet përgjegjëse.

❖ Disavantazhet:

- Puna përgatitore për hartimin e projektligjit të ri mund të kërkojë më shumë kohë për t’u realizuar, si dhe do të përfshijë një numër më të madh të burimeve administrative.
- Shfaqja e kundërshtimeve, kundër rregullave të reja, nga disa prej autoriteteve përgjegjëse për të propozuar dhënien e nderimeve dhe/ose për dhënien e këtyre nderimeve apo nga opinioni publik.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- ❖ *Identifikoni grupet e prekura.*
- ❖ *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
 - ❖ *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- ❖ *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- ❖ *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- ❖ *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Sikurse mund të konstatohet nga seksioni i mësipërm, zgjedhja e cilitdo prej opsioneve, veç optionit 3, nuk do të mundësonte përmbushjen me sukses të objektivave. Më konkretisht, po paraqesim më poshtë avantazhet dhe disavantazhet, direkte apo indirekte, të këtij optioni.

1. Avantazhet:

Direkte

i. Ekonomike

- Për subjektet që do t'i jepen tituj nderi dhe tituj vendorë nderi, dhënia e këtyre të fundit nuk do të shoqërohet me një shpërblim financiar në dallim nga legjislacioni aktual në fuqi, duke mos rënduar buxhetin e shtetit në këtë drejtim.
- Projektligji nuk parashikohet të sjellë rritje të shpenzimeve buxhetore pasi nuk përcakton detyra të reja të institucioneve zbatuese (dhënia e titujve të nderit është veprimtari ekzistuese) dhe as nuk sjell krijimin e institucionave, organeve, apo strukturave të reja.

ii. Sociale

Ndër ndikimet sociale direkte mund të listojmë:

- shtimin e motivimit dhe frymëzimit për kryerjen e veprimeve me vlerë e meritë për përparimin e shoqërisë dhe kombit;
- shtimin e ndjenjës së përkatësisë dhe pjesëmarrjes në një proces të rëndësishëm për njohjen e kontributeve të dhëna për komunitetin dhe Kombin shqiptar (procedura e iniciativës qytetare);
- lartësimi i vlerës së titujve të shpërndara;
- ruajtjen e imazhit të vendit nga zhvlerësimi i mëtejshëm për shkak të abuzimit me dhënien e titujve, që nënkupton një avantazh të madh social, ekonomik (indirekt), duke justifikuar plotësisht ndërmarrjen e kësaj nisme.

Indirekte

i. Sociale

Forcimi i unitetit shoqëror dhe i respektit për kontribuesit në përparimin e shoqërisë dhe kombit mund të evidentohet si një ndikim social indirekt i kësaj politike.

2. Disavantazhet:

Direkte

i. Ekonomike

Për subjektet që do t'i jepen tituj nderi dhe tituj vendorë nderi, dhënia e këtyre të fundit nuk do të shoqërohet me një shpërblim financiar në dallim nga legjislacioni aktual në fuqi.

Indirekte

i. Sociale

Disavantazhi, që mund të krijojë projektligji lidhet me subjektet të cilëve më parë i janë dhënë tituj nderi ose tituj vendorë nderi dhe të cilët për shkak të kryerjes së veprave penale do t'i hiqet titulli.

Arsyetimi i optionit të preferuar

Zgjidhni optionin e preferuar, bazuar në analizë.

Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni 3 është vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm referuar objektivit për rikonceptimin dhe riorganizimin e sistemit të titujve të nderit dhe titujve vendorë të nderit, si dhe në unifikimin e procedurave që ndiqen për dhënien e tyre nga autoritetet përgjegjëse. Këto objektiva të parashtruara në nivel makro nuk mund të arrihen nëpërmjet ruajtjes së *status quo*-së, pasi është e nevojshme ndërhyrja ligjore dhe as nëpërmjet opsionit 2, për shkak të ndryshimeve dhe risive që synohen të kryhen dhe realizohen në kuadër të përmbushjes së politikës për përmirësimin e sistemit të titujve të Republikën e Shqipërisë.

Pas vlerësimit në tërësi dhe me kujdes të këtyre opsioneve, rezulton se opsioni 3, pra hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, krijon mundësitë optimale për implementimin e plotë të politikës dhe arritjen efektive të objektivave të vendosura. Në kuadër të këtij opsioni, propozohet hartimi i një ligji të ri.

Në kuadër të kësaj politike, propozohet të implementohet një qasje e re, duke vendosur një sistem modern dhe jetëgjatë, pas analizimit të modeleve që zbatohen në shtete të ndryshme perëndimore (si Franca, Italia, Austria, Çekia dhe Sllovenia). Megjithatë, mendojmë se sistemi francez nuk mund të ndiqet *a la lettre* dhe është e nevojshme të kryhen disa modifikime për atë kohë sa ato do mbeten brenda kornizave të këtij sistemi (sikurse kanë vepruar shumë shtete Evropiane që zbatojnë modelin francez).

❖ Analiza me shumë kritere

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 1 –*status quo*-ja – Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legislative.

Opsioni 2 (*rregullator*): – Kryerja e ndryshimeve në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Opsioni 3 (*rregullator*): – Rregullimi me ligj të ri i sistemit të dekoratave në Republikën e Shqipërisë

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative:

- Rikonceptimi dhe riorganizimi i sistemit të titujve të nderit dhe titujve vendor të nderit në RSH, bashkëkohor dhe në linjë me modelet perëndimore - 5
- Unifikimi i procedurave për shqyrtimin e propozimeve për dhënien e titujve të nderit dhe titujve vendorë të nderit - 4
- Ruajtja e imazhit të vendit nga zhvlerësimi i mëtejshëm për shkak të abuzimit me dhënien e titujve nga autoritetet përgjegjëse - 3
- Plotësimi i boshllëkut legjislativ ndër vite, në drejtim të përcaktimit të rasteve për heqjen e titujve - 2
- Garantimi i së drejtës së njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e titujve të nderit, si dhe i mundësisë për të dhënë tituj bazuar edhe në propozimet që vijnë nga qytetarët -4
- Kosto-efektiviteti - 3

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Kriteret	Pesha	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
----------	-------	-----------	-----------	-----------

Rikonceptimi dhe riorganizimi i sistemit të titujve të nderit dhe titujve vendor të nderit në RSH, bashkëkohor dhe në linjë me modelet perëndimore	5	0 (0)	3 (5)	5 (25)
Unifikimi i procedurave për shqyrtimin e propozimeve për dhënien e titujve të nderit dhe titujve vendor të nderit	4	0 (0)	3 (12)	5 (20)
Ruajtja e imazhit të vendit nga zhvlerësimi i mëtijshëm për shkak të abuzimit me dhënien e titujve nga autoritetet përgjegjëse	3	0 (0)	3 (9)	4 (12)
Plotësimi i boshllëkut legjislativ ndër vite, në drejtim të përcaktimit të rasteve për heqjen e titujve	2	0 (0)	3 (6)	4 (8)
Garantimi i së drejtës së njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e titujve të nderit, si dhe i mundësisë për të dhënë tituj bazuar edhe në propozimet që vijnë nga qytetarët	4	0 (0)	5 (20)	5(20)
Kosto - efektiviteti	3	2 (6)	3(12)	4(12)
Pikët	-	6	64	97

Çështje të zbatimit

- ❖ *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- ❖ *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- ❖ *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë:

1. Presidenti i Republikës dhe Këshillat bashkiake, në cilësinë e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.
2. Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetarët e bashkive dhe cdo anëtar i këshillave bashkiake, në cilësinë e autoriteteve që kanë të drejtën e propozimit për nderim;
3. Këshilli i Ministrave i cili ngarkohet për nxjerrjen e akteve nëligjore.

Kontrolli për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore që nxirren në bazë dhe në zbatim të tij parashikohet të ushtrohet nga subjektet sipas detyrave, të drejtave dhe përgjegjësisë të përcaktuara në legjislacionin e ri.

Masa kryesore për arritjen e qëllimeve të politikës së synuar si dhe implementimin me sukses të projektligjit eventualisht të miratuar dhe të hyrë në fuqi, është hartimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, përmes të të cilave do të zbërthehen dhe rregullohen në mënyrë shteruese çështjet të caktuara, në varësi të autorizimeve ligjore.

Miratimi i këtyre akteve nënligjore në një kohë sa më të shpejtë, në çdo rast jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij projektligji (*detyrim i parashikuar në projektligj*) i shërben zbatimit të këtij projektligji në eventualitetin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij si dhe realizimit të qëllimit të politikës së synuar.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- ❖ *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- ❖ *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të këtij projektligji do të bëhet nga autoritetet përgjegjëse të sipërcituar, në kushtet kur kompetencat e tyre lidhen apo kanë të bëjnë me dhënien e titujve të nderit dhe titujve vendorë të nderit.

Monitorimi i zbatimit drejt të parashikimeve të këtij projektligji në eventualitetin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij do të bëhet nga autoritetet e sipërcituara në mënyrë të ndërsjellë, ku secila prej tyre do të luajë rolin e vet në respektimin e detyrimeve ligjore për shqyrtimin dhe dhënien e dekoratave.

Kriteret për të vlerësuar progresin e arritur përgjatë zbatimit të këtij ligji, janë të dhënat vijuese:

- ❖ Numri i titujve të nderit të dhëna nga Presidenti, me nismën e tij;
- ❖ Numri i titujve të nderit të dhëna nga Presidenti, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit ose Kryeministrit;
- ❖ Numri i titujve vendorë të nderit të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ❖ Numri i titujve të veçantë të nderit që do të krijohen njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ❖ Numri i titujve të hequr si rezultat i zbatimit të projektligjit;
- ❖ Numri i titujve të dhënë duke u mbështetur në kërkesat e paraqitura nga shtetasit për ushtrimin e nismës ose propozimit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										

Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total	
---	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

KRYEMINISTRI

EDI RAMA